

Numri i lëndës: 2024:038599

Datë: 07.03.2024

Numri i dokumentit: 05425404

C.nr.769/2024

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA V., gjyqtari Raif Fazliu, me bashkëpunëtoren profesionale Dardana Behluli, në çështjen kontestimore të paditësit F.B.nga fshati N., Komuna V., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.H., avokate në V., kundër të paditurës Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, vlera e kontestit 1,016.60 €, jashtë seancës gjyqësore, me datë 07.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.B.nga fshati N., Komuna V., **detyrohet** e paditura Komuna V.-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit, për 299 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 14.09.2020 deri me datë 21.11.2022, t’ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 598 € dhe shpenzimet e udhëtimit për periudhën e njejtë, në shumën 418.60 €, në shumë të përgjithshme **1,016.60 €**, me kamatë ligjore 8 %, e llogaritur nga dita kur është ushtruar padia me datë 01.02.2024 deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

II. Detyrohet paditësi që për vlerën e kontestit të paguajë shumën shtesë 10 € në emër të taksës gjyqësore për padi.

III. Detyrohet e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë 135 €, në afat prej 7 ditëve nga pranimi i aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarës së saj, me datë 01.02.2024, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës, me objekt kontesti kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, me vlerë të kontestit 1,016.60 €.

Me padi, paditësi ka theksuar se është i punësuar në ShFMU “S.R.”, në fshatin Z., Komuna V., ashtu që në emër të shpenzimeve për ushqim dhe udhëtim, nga gjykata ka kërkuar që për 299 ditë të pranisë në punë, për periudhën nga data 14.09.2020 deri me datë 21.11.2022, t’ia paguajë shpenzimet e ushqimit në shumën 598 € dhe shpenzimet e udhëtimit për periudhën e njejtë, në shumën 418.60 €, në shumë të përgjithshme 1,016.60 €. Bazën ligjore e ka mbështetur në Kontratën kolektive të Arsimit në Kosovë (tutje KKAK) të V.t 2017 dhe 2021. Për të mbështetur pretendimet si në padi, si prova ka propozuar Vërtetimin e punës, nr. 223/1, të datës 11.12.2023, Certifikatën e vendbanimit nr. B 10288199, të datës 28.10.2020 dhe Vërtetimin nga kompanitë transportuese që veprojnë brenda Komunës. Shpenzimet procedurale i ka kërkuar, 104 € për përpilimin e padisë dhe 31 € për taksën gjyqësore për padi.

E paditura, përmes përgjigjes në padi, ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me pretendimin se kërkesa nuk është e bazuar në ligj, pasi obligimet që dalin nga KKAK duhet të paguhen nga niveli qendror e po ashtu, ka theksuar se Qeveria e Republikës së Kosovës / Ministria e Arsimit e ka shkëputur këtë kontratë dhe rrjedhimisht edhe nuk mund të prodhojë obligim ligjor për të paditurën. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi të pa bazuar në ligj. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike civile, ka gjetur se asnjë nga faktet e paraqitura në padi nuk janë kontestuese: ekzistimi i marrëdhënies së punës, se nga data 14.09.2020 deri me datë 21.11.2022, paditësi ka qenë i pranishëm në punë 229 ditë e po ashtu se paditësi udhëton nga vendbanimi i tij për në vendin e punës, në relacionin N.-V.-Z. dhe anasjelltas, pasi edhe e paditura nuk i ka kontestuar këto fakte.

Mbështetur në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës gjykata i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror, këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Pas pranimit të përgjigjes në padi, gjykata ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës gjyqësore, duke u mbështetur në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK), me të cilin përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund të japë aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka ardhur në përfundim se të gjitha kushtet ligjore të përcaktuara në këtë nen janë plotësuar sepse, gjendja faktike nuk është kontestuese e po ashtu nuk ekzistojnë pengesa të tjera që pa caktuar seancë gjyqësore të pranohet si e themeltë kërkesëpadia e paditësit.

Meqë baza ligjore e kërkesëpadisë së paditësit mbështetet në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), nenin 245, par. 1, në të cilin është përcaktuar: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë atë me ndërjegjje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij” lidhur me nenin 35, par. 7 të KKAK-së, në fuqi nga data 18.04.2017 dhe ajo KKAK në fuqi nga data 21.01.2021, sipas të cilit është përcaktuar se: “Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) € për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit” si dhe par. 5 të të njëjtit nen, ku është përcaktuar se: “Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, i paguhen shpenzimet e rrugës 70 % të biletave të trafikut urban”, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Kundërshtimet e të paditurës janë gjetur të pa bazuara pasi kërkesa e paditësit është për periudhën sa kanë qenë në fuqi KKAK e V.t 2017 dhe 2021 ndërsa, palët kontraktuese të KKAK-së Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e

Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), në nenin 2, par. 1.2., kanë përcaktuar: “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” ndërsa, neni 37 ka përcaktuar se: “Palët nënshkruese të kësaj kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t’i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate.”

Pasi paditësi ka paguar vetëm shumën 20 € për taksën gjyqësore për padi ndërsa, për vlerën e kërkuar të kontestit duhet të paguhet shuma 30 €, gjykata, duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ nr. 01/2017, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë çështje kontestimore, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 449 dhe 453 të LPK-së, ashtu që në emër të shpenzimeve për taksë gjyqësore për padi dhe përpilim të padisë, detyroi të paditurën që paditësit t’ia paguajë shumën 135 €.

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 142 dhe 398 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA V.
C.nr.769/2024, Datë 07.03.2024

Gj y q t a r i,
Raif Fazliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet në këtë gjykatë.